

Dokument i shkurtër për politika publike nr.27/2020

-

# Pasqyrë krahasuese e rolit të parlamenteve në mbikëqyrjen anti-korrupsion në rajon

Autor: Simona Mladenovska

-

qershor 2020



*Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht i shprehin pikëpamjet e Fondacionit Nacional për Demokraci nga SHBA-ja dhe Institutit për demokraci "Societas Civilis" - Shkup*

# Impressum

—

**Titull:** Pasqyrë krahasuese e rolit të  
parlamenteve në mbikëqyrjen  
anti-korrupsion në rajon

**Botues:** Institutit për Demokraci  
“Societas Civilis” - Shkup

**Autor:** Simona Mladenovska

**Përkthim:** Litra

**Dizajni:** Dejan Kuzmanovski

**Ky publikim është i disponueshëm në:**

[https://idscs.org.mk/mk/portfolio/pasqyre-krahasuese-  
e-rolit-te-parlamenteve-ne-mbikeqyrjen-anti-korrupsion-  
ne-rajon/](https://idscs.org.mk/mk/portfolio/pasqyre-krahasuese-e-rolit-te-parlamenteve-ne-mbikeqyrjen-anti-korrupsion-ne-rajon/)

Roli mbikëqyrës i parlamentit është kyç për të siguruar përgjegjësinë në rritje dhe transparencën e pushtetit ekzekutiv. Duke pasur parasysh numrin dhe volumin e funksioneve që realizon pushteti ekzekutiv, rreziku nga korrupsioni është i madh prandaj deputetët si të zgjedhur nga populli duhet të shfrytëzojnë mekanizmat të cilat i kanë në dispozicion.

Ky tekst merret pikërisht me një nga masat parandaluese në luftën kundër korrupsionit e cila është e aksesueshme në demokracitë parlamentare të rajonit. Pikërisht, shqyrtohen format nëpërmjet të cilave parlamenti kryen mbikëqyrjen mbi institucionet kombëtare anti-korrupsion në: Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Serbisë, Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës, Republikën e Malit të Zi dhe Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës.

# Parlamenti dhe funksionet

---

Demokracitë parlamentare nuk mund të jenë funksionale pa transparencë dhe përgjegjshmëri. Në një sistem të tillë menaxhimi sigurimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë është detyrë që bie në barrë të Parlamentit. Përdorimi i funksionit mbikëqyrës i jep Parlamentit të drejtën të thërrasë në përgjegjësi qeverinë. Nëpërmjet ushtrimit të funksionit mbikëqyrës parlamentet mund të sigurojnë informimin e publikut për politikat, masat dhe veprimet e ndërmarra nga ana e institucioneve, dhe komplementaritetin i tyre me interesin publik.

Kjo edhe njëherë hedh dritë mbi parlamentin si institucioni qendror në luftën kundër korrupsionit. Parlamentet janë shtyllat e sistemeve demokratike të kontrollit dhe ekuilibrit, që luajnë rol kryesor në luftën kundër korrupsionit në

shumë aspekte. Para së gjithash, nga ushtrimi me konsistencë i mandateve që ka në dispozicion.

Rëndësia e këtij roli të Parlamentit del nga **funksioni i tij legjislativ, mbikëqyrës dhe reprezentativ**. Këto funksione janë njohur nga shumica e aktorëve relevantë, ndërkombëtarë si Misioni i OSBE-së dhe organizata, siç janë Unioni Interparlamentar (UIP) dhe Organizata Globale e Deputetëve kundër Korrupsionit (GOPAC).<sup>1</sup>

Nëpërmjet **mandatit legjislativ**, parlamentet janë kompetente për vendosjen e kornizës adekuatë dhe të fuqishme për parandalimin e korrupsionit. Ky mandat nuk mbaron vetëm me miratimin e akteve ligjore vendase, por edhe me përfaqësimin e ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit para qeverive kombëtare. Me ushtrimin adekuat të këtij funksioni parlamenti luan edhe rol esencial në promovimin e standardeve për integritet

---

<sup>1</sup> Chene, Marie. 2017. *What Works in Working with Parliaments Against Corruption*. Anti-Corruption Resource Centre.

nëpërmjet stimujve, mekanizmave dhe sanksioneve.

### **Funksioni mbikëqyrës i parlamentit**

është i një rëndësie të veçantë në procesin e luftës kundër korrupsionit. Nga ai del e drejta e Parlamentit për të realizuar rolin mbikëqyrës mbi pushtetin ekzekutiv. Ushtrimi i këtij funksioni është i një rëndësie thelbësore për konfirmimin e parlamentit si institucion qendror në efikasitetin e luftës kundër korrupsionit.

Që këtu edhe në fokusin e tekstit të mëtejshëm do të jenë format e përfshirjes së parlamenteve në luftën kundër korrupsionit në vendet e rajonit. Do të shqyrtohen ngjashmëritë, dallimet dhe veçoritë specifike të këtyre formave.

## **Pasqyrë e mbikëqyrjes parlamentare**

### **1.1. Republika e Maqedonisë së Veriut**

Në rastin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) është institucioni i drejtpërdrejtë kompetent për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave. Në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave<sup>2</sup> të vitit 2019, përbërjen e KSHPK-së e zgjedh Kuvendi nëpërmjet thirrjes publike dhe procedurës publike. Ajo që duhet të kihet parasysh është se **KSHPK-ja është një organ parandalues**, i cili për punën e tij përgjigjet para Kuvendit.

Mandati mbikëqyrës i Kuvendit të R.M.V. nuk mbaron me këtë institucion. Deputetët kanë mandat për të kërkuar sqarime për pozitat e Prokurorisë Publike,

---

<sup>2</sup> Gazeta zyrtare e R.M.V., Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e interesave, 12/2019

përfshirë këtu edhe Prokurorinë Publike për Kriminalitetin e Organizuar. Mandati mbikëqyrës vazhdon edhe mbi Qeverinë, dhe me të edhe mbi institucionet e tjera nën mbikëqyrjen e saj, si Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria e Financave.

Në parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ekziston komision ose organ tjetër që merret me vetëm me çështjet e lidhura me korrupsionin. Në mungesë të komisionit të specializuar, kompetenca i përket Komisionit Parlamentar për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësisë.<sup>3</sup>

## 1.2. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Koordinimit të Luftës kundër Korrupsionit (APKK) është një organizatë administrative e pavarur dhe autonome

e cila për punën e saj përgjigjet para Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës.<sup>4</sup>

Në kornizat e Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës ka një komision të veçantë për ndjekjen e punës së Agjencisë. Komisioni për zgjedhjen dhe ndjekjen e APKK-së është një organ i pavarur në kornizat e parlamentit kompetencat e të cilit dalin nga Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Koordinimin e Luftës kundër Korrupsionit.

Komisioni përbëhet nga nëntë anëtarë, tre nga të cilët janë përfaqësues të Dhomës së Përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës, tre anëtarë janë përfaqësues të Dhomës së Popujve të Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës, dy anëtarë janë përfaqësues të bashkësisë akademike dhe një anëtar është përfaqësues i sektorit civil.<sup>5</sup> Mandati i përfaqësuesve të Dhomës së Përfaqësuesve dhe Dhomës së Popujve

<sup>3</sup> "Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhëniet ndërmjet Bashkësisë." Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. 15 Qershor. E aksesueshme në Qershor 15, 2020 <[https://www.sobranie.mk/rabotni-tela-2016-2020-ns\\_article-komisija-za-politicki-sistem-i-odnosi-megju-zaednicite-16.nspj](https://www.sobranie.mk/rabotni-tela-2016-2020-ns_article-komisija-za-politicki-sistem-i-odnosi-megju-zaednicite-16.nspj)>

<sup>4</sup> "Themelimi dhe Statusi." Agjencia për Korrupsion dhe Luftë kundër Korrupsionit. E aksesueshme në Qershor 15, 2020. <http://www.apik.ba/o-nama/default.aspx?id=35&langTag=bs-BA>.

<sup>5</sup> "Komisioni për zgjedhjen dhe ndjekjen e punës së komisionit dhe koordinimit të luftës kundër korrupsionit." Asambleja Parlamentare e Bosnjës dhe Hercegovinës. E aksesueshme në Qershor 15, 2020. <<https://www.parlament.ba/committee/read/19.>>



është me mandat sa edhe ai i përbërjes parlamentare. Përfaqësuesit e bashkësisë akademike dhe përfaqësuesi i sektorit civil kanë mandat 4 vjeçar, duke filluar nga dita e emërimit.

### 1.3. Republika e Serbisë

Në Serbinë fqinje Agjencia për Luftën kundër korrupsionit është formuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin për Luftën kundër Korrupsionit.<sup>6</sup> Në kornizat e Agjencisë funksionon Këshilli i përzier i cili numëron tetë anëtarë.

Kuvendi Popullor ka mandatin për mbikëqyrjen e Agjencisë për Luftën kundër Korrupsionit. Mbikëqyrja me Kuvendin realizohet nëpërmjet Këshillit, administratës shtetërore dhe qeverisjes vendore. Në përbërjen e Këshillit hyjnë 17 anëtarë nga përbërja parlamentare. Ky këshill nuk është specializuar për mbikëqyrjen mbi Agjencinë, por për njërin nga fushat që mbulon.

### 1.4. Republika e Shqipërisë

Inspektorati i Lartë për Kontrollin e Mjeteve dhe Konfliktit të Interesave është institucion qendror i pavarur. Inspektorati vepron në fushën e parandalimit të konfliktit të interesave, informimit dhe mbrojtjes së informatorëve. Inspektorati udhëhiqet nga Inspektorati i Përgjithshëm, të cili e emëron Kuvendi Popullor, me mandat prej 7 vjetësh.

Kompetencat e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë përfundojnë me zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm në Inspektoratit të Lartë.

Mbikëqyrja parlamentare mbi Inspektoratin e Lartë është indirekte. Pikërisht, Inspektori i Përgjithshëm është nën mbikëqyrjen e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Koordinatori Kombëtar kundër korrupsionit, nga ana tjetër, është pjesë e Këshillit të Ministrave. Parlamenti ka mandat për emërimin, shkarkimin dhe mbikëqyrjen e Këshillit të Ministrave.

---

<sup>6</sup> Gazeta Zyrtare e R. Së Serbisë, Ligji për Agjencinë për Luftën Kundër Korrupsionit, e aksesueshme: 14.06.2020

<sup>7</sup> Milosheviq, Milena. 2012. *Bordi për antikorrupsion*;; ilaç apo placebo. Dokument i shkurtër për politika publike, Podgoricë Instituti Alternativa

## 1.5. Republika e Malit të Zi

Roli parlamentar në luftën kundër korrupsionit në Malin e Zi, nga pikëpamja joformale mund të shqyrtohet në dy etapa: para dhe pas vitit 2012.

Në periudhën deri në vitin 2012, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është organi kryesor anti-korrupsion në Malin e Zi. Në kornizat e Agjencisë, funksionon Këshilli prej pesë anëtarësh me mandat pesëvjeçar, të cilët i zgjedh Parlamenti i Malit të Zi. Nga radhët e pesë të zgjedhurve zgjidhet kryetari i të njëjtit. Mbikëqyrja mbi punën e Agjencisë kryhet në kornizat e Këshillit Parlamentar për Sistem Politik,

gjyqësor.<sup>8</sup> Në këtë periudhë, në mungesë të një organi të veçantë, ky këshill është homolog i Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i shikuar nga aspekti i kompetencave me të cilat disponon.<sup>9</sup>

Në vitin 2012 fillon të shfaqet ideja për fuqizimin e parlamentit në luftën kundër korrupsionit.<sup>10</sup> Përveç ekspertëve për këtë ide vëmendje adekuate jep vetë Parlamenti i Malit të Zi dhe shërbimet e tij për mbështetje teknike.<sup>11</sup> Kështu me ndryshimet e Rregullores për Kuvendin të vitit 2012 parashikon themelimin e Këshillit Anti-korrupsion.<sup>12</sup>

<sup>8</sup> Seliq, Ana. Propozim për rritjen e rolit dhe efektivitetit të Parlamentit të Malit të Zi në luftën kundër korrupsionit. Studim, Qendra për monitorim dhe hulumtim.

<sup>9</sup> "Bordi për sistem politik, drejtësi dhe administratë." Kuvendi i Malit të Zi. I aksesueshëm në Qershor 15, 2020. <<http://www.skupstina.me/index.php/me/odbor-za-politicki-sistem-pravosude-i-upravu/o-radnom-tijelu>.>

<sup>10</sup> Seliq, Ana. Propozim për rritjen e rolit dhe efikasitetit të Parlamentit të Malit të Zi në luftën kundër korrupsionit. Studim, Qendra për Monitorim dhe Hulumtim.

<sup>11</sup> Instituti Parlamentar i Kuvendit të Malit të Zi. 2012. "Organ pune parlamentar i cili merret me çështjet e luftës kundër korrupsionit." Punë hulumtuese, Podgoricë. E aksesueshme në Qershor 15, 2020. <<http://www.skupstina.me/images/dokumenti/biblioteka-i-istranzvanje/Parlamentarno%20radno%20tijelo%20koje%20se%20bavi%20pitanjima%20borbe%20protiv%20korupcije.pdf>.>

<sup>12</sup> Milosheviq, Milena. 2012. Bordi për antikorrupsion;: ilaç apo placebo. Dokument i shkurtër për politika publike, Podgoricë: Instituti Alternativa

Këshilli për anti-korrupsion formohet si organ i përhershëm i Parlamentit të Malit të Zi. Në përbërjen e tij hyjnë gjithsej 13 anëtarë, nga të cilët tetë vijnë nga pushteti dhe pesë nga opozita.

Me këtë Parlamenti i Malit të Zi fiton një organ me kompetenca sociale për mbikëqyrjen dhe analizën në punën e organeve shtetërore, organizatave dhe organeve në luftën kundër korrupsionit.

## 1.6. Republika e Kosovës

Republika e Kosovës ka Agjenci anti-korrupsion funksionimi dhe mbikëqyrja e së cilës janë rregulluar me Ligjin për Luftën kundër Korrupsionit.

Pikërisht, agjencia ka këshill i cili kryen mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë mbi punën e saj. Këshilli është organ i përhershëm

që është në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin.

Këshilli përbëhet nga nëntë anëtarë, nga të cilët tre emëron Kuvendi. Gjashtë anëtarët e tjerë vijnë nga Kabineti i Presidentit të Shtetit, Qeveria, Gjyqi Suprem, Prokuroria Publike, pushteti lokal dhe shoqëria civile. Këshilli i Agjencisë Anti-korrupsion ka si obligim dorëzimin e raportit vjetor të Agjencisë të cilin e shqyrton dhe miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në parlamentin e Kosovës nuk ka komision të veçantë në luftën kundër korrupsionit. Mbikëqyrja mbi Agjencinë kundër Korrupsionit hyn nën kompetencat e Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren për Punë të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë për Luftën kundër Korrupsionit.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> "Komisioni për Legjislacion, mandate, imunitete, rregullores për punë të Kuvendit dhe mbikëqyrje mbi Agjencinë për Luftën Kundër Korrupsionit." Parlamenti i Republikës së Kosovës. I aksesueshëm në Qershor 2020, 2020 <<http://www.kuvendikosoves.org/eng/comittees/committee/?committee=21#documents>.>

# Specifika të mbikëqyrjes anti-korrupsion

Ajo që mund të shihet nga një vështrim i shkurtër rajonal është se, në përgjithësi, gjashtë vendet e rajonit mund të kategorizohen afërsisht në tre grupe:

1. Vendet që nuk kanë krijuar një strukturë parlamentare për mbikëqyrje;
2. Vendet që kanë një strukturë të përgjithshme mbikëqyrëse parlamentare;
3. Vendet që kanë një strukturë të specializuar mbikëqyrjeje.

Në grupin e parë hyn Republikën e Shqipërisë, e cila nuk ka mbikëqyrje të drejtpërdrejtë parlamentare. Mbikëqyrja parlamentare e Shqipërisë kundër

korupsionit është sekondare nëpërmjet të Këshillit të Ministrave.

Republika e Serbisë, Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës kanë shenja të përbashkëta që karakterizojnë mbikëqyrjen parlamentare. Në këto vende, mbikëqyrja zhvillohet përmes komisioneve parlamentare që nuk janë të specializuara për lëmin. Me fjalë të tjera, këto janë komisione, në volumin e punës së të cilave hyjnë një numër më i madh fushash, ndërmjet të cilave edhe lufta kundër korupsionit.

Ekziston një ngjashmëri shtesë në mënyrën se si është strukturuar mbikëqyrja në Serbi dhe Kosovë. Në të dy rastet, ekziston një bord i përhershëm, d.m.th. këshill, në institucione të pavarura për të parandaluar korupsionin. Në të dy rastet bordi ka rol mbikëqyrës mbi punën e institucionit në kornizat e të cilit funksionon. Përbërja është e përzier, por në të dy vendet në përbërje hyjnë personat e emëruar nga Parlamenti.

E përbashkët për mbikëqyrjen parlamentare që praktikohet në Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë janë komisionet që merren posaçërisht me mbikëqyrjen kundër korrupsionit.

Edhe pse ekzistojnë komisione të ndara në të dy vendet, të dyja ndryshojnë ndërmjet tyre. Përkatësisht, në Mal të Zi bëhet fjalë për një komision të përbërë ekskluzivisht nga parlamentarë. Ndërkohë, komisioni në Bosnjë dhe Hercegovinë ka një përbërje të përzier të deputetëve, përfaqësuesve të bashkësisë akademike dhe shoqërisë civile.

## Rezyme

---

Në pesë nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor te të cilët është bërë shqyrtimi, parlamentet kanë rol në mbikëqyrjen anti-korrupsion. Përkatësisht, mbikëqyrja parlamentare mungon vetëm në Republikën e Shqipërisë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Serbi, Kosovë, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë korniza ligjore parashikon mbikëqyrjen parlamentare mbi anti-korrupsionin.

Organet që kryejnë mbikëqyrjen parlamentare ndryshojnë kryesisht në volumnin e fushave hyjnë në sferën e veprimit të tyre. Në rastet e Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës, vihet re një mbikëqyrje e ngushtë dhe e synuar parlamentare. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Serbi dhe Kosovë mbikëqyrja kryhet përmes komisioneve parlamentare që punojnë në një spektër më të gjerë fushash.

Vendet e rajonit ndryshojnë jo vetëm në specifikën e mbikëqyrjes parlamentare, por edhe në përbërjen e organeve që kryejnë mbikëqyrjen në parlament. Në vendet që janë lëndë e këtij shqyrtimi, dallojmë përbërje parlamentare dhe të përzier.

Përbërja parlamentare ekziston në Mal të Zi, Kosovë, Shqipëri dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këto vende, anëtarët e organeve mbikëqyrëse të parlamentit vijnë nga radhët e parlamentit. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, nga ana tjetër, përbërja e komisionit është e përzier. Përveç deputetëve të të dy dhomave të përfaqësuesve përfshin edhe përfaqësues të bashkësisë akademike dhe sektorit civil

## Informacion mbi projektin

---

Bisedime anti-korrupsion në Parlament është projekt i cili synon fuqizimin e rolit mbikëqyrës të deputetëve në fushën e luftës kundër korrupsionit. Projekti është financuar nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci nga SHBA-ja.

## Informacion mbi IDSCS

---

IDSCS është think tank - organizatë civile që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian të Maqedonisë. IDSCS ka për mision ndihmën e angazhimit qytetar në vendimmarrje dhe për të forcuar kulturën pjesëmarrëse politike. Duke zhvilluar vlerat liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën midis diversitetit.

### **Informatat kontaktuese për IDSCS**

---

Adresë: Str. Miroslav Krlezha No.  
52/1 /2, 1000 Shkup  
Telefoni / Fax: +389 2 3094760  
E-Mail: [contact@idscs.org.mk](mailto:contact@idscs.org.mk)

## Për autorin

---

**Simona Mladenovska** është një studiuese e re në Qendrën për Menaxhim të Mirë në Institutin për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup. Përgjegjëse për Sekretariatit e Platformës së Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën Kundër Korrupsionit.

## Link

---

**Ky publikim është në dispozicion në:**

-

<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/pasqyre-krahasuese-e-rolit-te-parlamenteve-ne-mbikeqyrjen-anti-korrupsion-ne-rajon/>



Dokument i shkurtër për  
politika publike nr.27/2020

---

## Pasqyrë krahasuese e rolit të parlamenteve në mbikëqyrjen anti-korrupsion në rajon

Autor: Simona Mladenovska  
-  
qershor 2020